



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - HANI I ELEZIT
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE



07/Nr. 2225 /2021

Komuna Hani i Elezit në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017 me datë 24.03.2021 shpallë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Mjekë/e të Mjekësisë Familjare për kohë të pacaktuar
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Njësia/sektori: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr.Menduh Kaloshi" Hani i Elezit
Numri i pozitave: 2 (Dy) në **Han të Elezit**
Koeficienti/Grada: H-27 .Gr.St/ H - 565 / 1

Përshtkrimi i përgjithshëm i detyrave të punës

1. Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëmin të cilën është trajnuar.
2. Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë, kartelën e pacientit si dhe dokumente të tjera.
3. Jep udhëzime me gojë dhe me shkrim për trajtime të pacientit .
4. Merr pjesë në hartimin e planit dhe programit në vendin e punës ku punon.
5. Mban kujdestarinë e radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit në QKMF dhe teren.
6. Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i aplikon masat.
7. Ndhmon në preventivin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët në lidhje me dietën ushtrimet, higjienën dhe shëndetin në përgjithësi.
8. Të raporton për lindjet, vdekjet, sëmundjet ngjitëse autoriteteve kompetente.
9. Të i referon pacientët tek specialistët mjekësorë dhe të shkëmben me ta të dhënat mjekësore.
10. Të përpilon raporte me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tij.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik janë:

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale me dashje, të mos ketë në fuqi asnjë masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.
Përveç kushteve të përgjithshme të cekura më lartë kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kërkesa:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës (letërnjoftimi) fotokopje.
2. Të kenë të kryer Fakultetin e Mjekësisë (Diploma) e vërtetuar në Komunë ose tek Noteri.
3. Të kenë të kryer Praktikën profesionale dhe të vërtetuar (Licenca) e vërtetuar në komunë ose Noteri.
4. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (Tatimi në pronë).
5. Certifikata e mjekut.

6. Vërtetim nga gjykata që nuk ndjekej penalisht.
7. Kualifikime tjera (Trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **24.03.2021 deri 07.04.2021 (16:00).**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati I (pare) dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Komuna e Hanit të Elezit i shërben të gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet për meshkuj dhe femrat prej të gjitha komuniteteve kosovare.

Drejtoreshë e DSHMS-së

Medina Imishti

